



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 20/DPK Nr Prot 01-4246/15  
 Dep. 06 Br Prot 01-4246/15  
 Nr.faq. 06 Data 18.11.2015  
 Broj stranica 06 Datum 18.11.2015  
 Nr. pages 06 Date 18.11.2015

PRISHTINE

DATË/A:	18.11.2015
REFERENC-Ë:	<b>DPK- DPKPP-03-03/3646/15</b>
PËR/ZA/TO:	z. Azem DURAKU Menaxher i Departamentit të Prokurimit në Administratën Tatimore të Kosovës
CC:	z. Hamit MULAJ - zv. Drejtor i Përgjithshëm i Përkrahjes në ATK z. Nahit SHARKU - ud. Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Servisimi dhe Mirëmbajtja e veturave zyrtare i llojit Nissan Terano, Toyota 4 runner, Golf IV 1.9 TDI, Pollo 1.4 dhe Hyndai sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së "

*I nderuari z. Duraku ,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Servisimi dhe Mirëmbajtja e veturave zyrtare i llojit Nissan Terano, Toyota 4 runner, Golf IV 1.9 TDI, Pollo 1.4 dhe Hyndai sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së " me numër prokurimi: 11600-15-011-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Servisimi dhe Mirëmbajtja e veturave zyrtare i llojit Nissan Terano, Toyota 4 runner, Golf IV 1.9 TDI, Pollo 1.4 dhe Hyndai sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së ", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

## Arsyetime

Administrata Tatimore e Kosovës si Autoritet kontraktues, përmes Departamentit të Prokurimit ka iniciuar Procedurën e Prokurimit publik me titull " *Servisimi dhe Mirëmbajtja e veturave zyrtare i llojit Nissan Terano, Toyota 4 runner, Golf IV 1.9 TDI, Pollo 1.4 dhe Hyndai sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së* " me nr. Prokurimi 11600-15-011-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.30.07.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurë të hapur, kontratë kornizë 2 vjeqare të llojit shërbime me vlerë të madhe.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt. 27.10.2015, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion ku ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që ta dorëzoj në Agjenci tërë dokumentacionin për këtë procedurë të prokurimit. Autoriteti Kontraktues me dt.28.10.2015 ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar. Agjencia pasi ka trajtuar tërë dokumentacionin në dispozicion dhe e ka analizuar të njëjtin ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë 5 lote (pjesë) ku në lot 1 është paraparë Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të ATK-së Nissan Terrano 2.7 TDI, lot 2 Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare Toyota 4 Runner, Lot 3 Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare Golf 4 variant 1.9 TDI 4 motion, lot 4 Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare Polo 1.4 dhe lot 5 Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare Hyndai starex.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë tender AKK ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **16** Operator ekonomik, ndërsa **9** prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë, ku për lot 1 kanë ofertuar 7 Operator ekonomik, për lot 2 kanë ofertuar 7, për lot 3 kanë ofertuar 9, për lot 4 kanë ofertuar 8 Operator dhe për lot 5 kanë ofertuar 5 Operator ekonomik.

Çmimet e ofruara nga Operatorët ekonomik të lexuara në hapjen e tenderëve kanë qenë si në vijim:

Për lot 1 çmimet janë ofruar si në vijim: **Nsh te Baci** 33,873.90 €, **Global Development Kosova** 41,526.10 €, **LTG Kosova** 42,496.37€, **DPZ Suzuki** 35,353.00 €, **NTP Univerzal comerc** 27,270.50 €, **Allmakes Global Services AGS** 10,871.69 €, **Fordi N.t.sh** 41,009.10.

Për lot 2 **Nsh te Baci** 26,107.50 €, **Global Development Kosova** 40,177.10 €, **LTG Kosova** 38,427.27 €, **DPZ Suzuki** 27,573.00 €, **NTP Univerzal comerc** 21,853.50 €, **Allmakes Global Services AGS** 9,979.07 €, **Fordi N.t.sh** 25,494.70 €.

Për lot 3 **Nsh te Baci** 18,416.51 €, **Global Development Kosova** 27,237.90 €, **LTG Kosova** 28,704.94 €, **DPZ Suzuki** 21,229.00 €, **NTSH Sfishta** 31,418.50 €, **Reforma Sh.p.k** 27,099.20 €, **NTP Univerzal comerc** 16,187.00 €, **AGS** 16,821.57 €, **Fordi N.t.sh.** 26,553.60 €.

Për lot 4 Nsh te Baci 13,849.98 €, Global Development Kosova 17,685.30 €, LTG Kosova 19,980.98 €, DPZ Suzuki 11,449.00 €, NTSH Sfishta 19,343.85 €, Reforma Sh.p.k 19,560.95 €, NTP Univerzal comerc 13,057.30 €, AGS 8,219.66 €, Fordi N.t.sh. 15,354.40 €.

Për lot 5 Nsh te Baci 1,096.00 €, Global Development Kosova 1,051.60 €, DPZ Suzuki 804.00 €, AGS 579.35 €, Fordi N.t.sh. 737.00 €.

### *Vlerësimi i ofertave nga Komisioni vlerësues*

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve të dt.21.10.2015, Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve ka konstatuar se për lot 1 janë pranuar 5 oferta të përgjegjshme dhe ka rekomanduar që kontrata t'i ipet Operatorit ekonomik Allmakes Global Services - AGS me çmim prej 22,522.47 €. Agjencia kundër Korrupsionit vëren se çmimi i lexuar në hapje për këtë Operator ekonomik ka qenë 10,871.69 €, ndërsa gjatë vlerësimit të tenderëve, Komisioni vlerësues ka konstatuar se ka gabime aritmetikore dhe vlera e ofertës financiare ka arritur në 22,522.47 € e që del të jet se çmimi ka ndryshuar mbi 100 % të ofertës financiare të lexuar në hapjen e tenderit.

Agjencia pasi ka analizuar shkaqet e këtij ndryshimi të çmimit ka konstatuar se Operatori ekonomik AGS me rastin kur e ka plotësuar listën e çmimeve tek oferta financiare i ka llogaritur vetëm çmimet për njësi më saktësisht çmimin e pjesës dhe shërbimit pa i shumëzuar të njëjtat me sasinë e parashikuar, e që për dallim prej tij Operatorët tjerë ekonomik e kanë plotësuar duke i shumëzuar çmimet për njësi me sasinë e parashikuar të pjesëve. Këtë korrigjim aritmetikor e ka pranuar dhe është pajtuar me të edhe Operatori ekonomik në fjalë. I njëjti Operatori ekonomik edhe për lot 2 ka bërë gabim në plotësimin e listës së çmimeve ku nga çmimi 9,979,07 € është bërë korrigjimi aritmetikor në 22,176,75 €, për lot 3 nga çmimi 16,821.57 €, është bërë korrigjimi aritmetikor në 25,658.68 €. Gjithashtu edhe për lot 4 e 5 ka gabime aritmetikore ku për lot 4 nga çmimi prej 8,219.66 € është përmirësuar gabimi aritmetikor i cili rritet në vlerën prej 13,415.63 € dhe tek lot 5 është bërë përmirësimi aritmetikor nga 579.32 € në 704.75 €. Në të gjitha këto pjesë kemi korrigjim të gabimeve aritmetikore në vlerën mbi 100 % të çmimit total i cili është lexuar me rastin e hapjes së tenderëve. Tek ofertat e Operatorëve tjerë ekonomik ka pasur gabime aritmetikore, por që kanë qenë gabime të vogla.

Për më tepër nga pyetjet e Operatorëve ekonomik që kanë parashtruar para dorëzimit të tenderëve dhe në sqarimet e Autoritetit Kontraktues që i'u ka drejtuar Operatorëve ekonomik vërehet se A.K. i'u ka dhënë udhëzimet e nevojshme se si të plotësohet lista e çmimeve përkatësisht oferta financiare. Mirëpo edhe përkundër udhëzimeve të dhëna nga Autoriteti kontraktues, megjithatë njëri nga Operatorët ekonomik më saktësisht AGS është i vetmi i cili nuk ka vepruar konform këtyre udhëzimeve, i njëjti ka vepruar në këtë mënyrë duke i shumëzuar çmimet e pjesëve dhe të shërbimeve vetëm për njësi pa i shumëzuar të njëjtat me sasinë e parashikuar. Sipas udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ( UOPP ) në asnjërën prej pikave

të nenit 35 paragrafi 9 nuk janë paraparë që gabimet e tilla si në rastin konkret që mund të korrigjohen. Sipas këtij udhëzimi parashihet shprehimisht se “ Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë do të jenë të obligueshme për tenderuesin. Tenderuesi do të njoftohet me shkrim menjëherë për korrigjimet e tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga A.K. në këtë mënyrë :

a) Në rast se ekziston një mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, shuma e shprehur në fjalë do të mbizotërojë, b) Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është marrë duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet, c) Në rast nëse ka një gabim në shumën e përgjithshme, që korrespondon me mbledhjen e nëntotaleve, nëntotali i cili është korrigjuar pas llogaritjes së çmimit për njësi dhe vlerën e përgjithshme do të mbizotërojë, d) shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin, e) Në rast se tenderuesi nuk i pranon ato, tenderi i tij do të refuzohet, f) Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr.

#### *Shkeljet sipas AKK-së*

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit vëren se dosja standarde e aprovuar nga KRPP për kontratën kornizë - shërbime procedurë e hapur, për këtë aktivitet të prokurimit është modifikuar në kundërshtim me ligjin. Nëse e analizojmë kolonën e fundit të dosjes së tenderit dhe formulën brenda kësaj kolone, me pas sqarimin që i'u është bërë operatorëve lidhur me mënyrën e llogaritjes së çmimit, vërejmë se në formulë kërkohet diçka tjetër, ndërsa në sqarimin e ofruar nga Autoriteti kontraktues se si duhet të plotësohet lista e çmimeve i'u është kërkuar operatorëve të kalkulojnë edhe sasinë e parashikuar në kundërshtim me formulën e vendosur në kolonën e fundit të dosjes së tenderit. Nuk ka përputhje në mes listës së çmimeve nga dosja e çertifikuar në KRPP dhe listës së çmimeve në dosjen e cila i'u është shpërndarë ofertuesve konkurrues.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i ulët sipas peshimit të grupit të pozicioneve të përcaktuara në aneksin 6 të dosjes së këtij tenderi. Autoriteti kontraktues ka paraparë 90 pikë prej pozicionit 1-77 për pjesët që blihen më shpesh dhe 10 pikë prej pozicionit 77 e tutje për pjesët që blihen më pak nga Autoriteti kontraktues. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentet e këtij tenderi me konkretisht vendimin për fillimin e vlerësimit të tenderëve dhe raportin përfundimtar të vlerësimit të tenderëve vëren se ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i tenderëve ka zgjatur afër 2 muaj. Sipas nenit 35 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik vlerësimi i tenderëve mund të zgjas deri në 30 ditë, ndërsa si përjashtim ka paraparë që në rast të vlerësimit të tenderëve me kompleks, vlerësimi i tenderëve mund të zgjatet edhe për 10 ditë tjera, mirëpo në rastin konkret Agjencia kundër Korrupsionit konsideron nuk kemi të bëjmë me ndonjë vlerësim kompleks dhe në asnjë mënyrë nuk arsyetohet vonesa e

përfundimit të vlerësimit deri në 2 muaj. Autoriteti Kontraktues duhet të kujdeset që vlerësimet e tenderëve të kryhen konform afateve ligjore siç janë paraparë me dispozitat e LPP-së dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Në Dosjen e Tenderit që ka përgatitur Autoriteti Kontraktues më saktësisht tek lista e çmimeve tek lot 1 nga pozicioni 1 deri në pozicionin 101, Autoriteti kontraktues ka paraparë sasi të përafërta të pjesëve që do të ndërrohen, ndërsa prej pozicionit 102 deri në 322 tabelat tek sasi të përafërta janë plotësuar vetëm me numrin 1 dhe në këtë mënyrë nuk janë paraparë sasi të përafërta e që konsiderojmë se ky veprim i Autoritetit Kontraktues bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Sipas Udhëzimit administrativ nr.2/2015 për kontratat publike kornizë i nxjerrë nga Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik neni 5 paragrafi 1 “ Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikativë, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag dhe do të lejoj derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se **plus/ minus 30 %**. Në paragrafin 2 i këtij neni cekët në mënyrë decitive se nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikativë ose vlerën totale indikativë të kontratës publike kornizë, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të kontratës publike kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk i parashihet sasi të përafërta në dosjen e tenderit, atëherë ka rrezik që totali i çmimit të ekzekutimit të kontratës ta tejkalojë vlerën e devijimit plus/minus 30 %. Për më tepër në dosjen e tenderit është paraparë mundësia që Autoriteti kontraktues e ka lirinë e veprimit për të blerë më pak ose më shumë sasi se sa sasi të parashikuara për artikull pa e paraparë devijimin e lejuar plus/minus 30%, pikë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se bie ndesh me nenin 5 të këtij udhëzimi.

Agjencia kundër Korrupsionit vëren se edhe në lotet tjera të këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti kontraktues në shumicën e pozicioneve nuk ka paraparë sasi të përafërta të pjesëve që do të blihen, duke i plotësuar vetëm me 1 sasi të parashikuara. Zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit me dt.09.11.2015, kanë organizuar edhe një takim me Menaxherin e Departamentit të Prokurimit në ATK në lidhje me këtë pikë dhe i njëjti është deklaruar se në pozicionet ku nuk janë paraparë sasi të përafërta të pjesëve nuk kemi mundur të parashikojmë sasi të përafërta dhe nuk kemi dashur të caktojmë sasi fiktive, qëndrim ky që konsiderojmë se nuk është i arsyeshëm dhe nuk ka bazë ligjore.

Bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik neni 26 paragrafi 1, 2 dhe 3 Autoriteti Kontraktues duhet të specifikoj sasi të gjatë përgatitjes së materialit tenderues, po ashtu në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasi mund të mos jenë të parashikuara në mënyrë precize, duhet të bëhet një parashikim i përafërt i sasive. E jo si në rastin e Autoritetit Kontraktues ku përveç përshkrimit të llojit të automjeteve që do të servisohen si dhe llojit të pjesëve të cilat do të servisohen- furnizohen nuk ka asnjë përshkrim tjetër të sasive përveç numrit 1, sasia është e pa

definuar. Pastaj gjatë vlerësimit të ofertave vlera e përgjithshme e kontratave ose vlera e parashikuar e kontratës kornizë duhet të kalkulohet në bazë të çmimeve të artikujve duke shumëzuar me sasi të relevante ose sasi të përafërta të kërkuara në dosjen e tenderit.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, nenin 26 Sasi të lidhje me kontratat për mallra, punë dhe shërbime të Rregullores për Prokurimin Publik, nenin 35 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, dhe nenin 5 Vlera dhe sasia e kontratës publike kornizë e udhëzimit administrativ nr.2/2015 për Kontratat publike kornizë.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !